



Ne bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), lidhur me nenin 40, paragrafi 2, shkronja (h) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008” dhe neneve 11, 15, dhe 28 paragrafi 2 pika (h) lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 31.05.2023, miraton këtë:

## V E N D I M PËR SHPALLJE “QYTETAR NDERI” I KOMUNËS SË SUHAREKËS

### Neni 1

Me këtë vendim, ish-Kryetari i qytetit të Fellbahut të Gjermanisë, z. **Christoph Martin PALM** i lindur me 01.09.1966 në Waiblingen të Gjermanisë, shpallet “QYTETAR NDERI” i Komunës së Suharekës.

### Neni 2

Me rastin e shpalljes qytetar nderi, Kryetari i Komunës së Suharekës, do t'i dorëzojë z. **Christoph Martin PALM** medaljen “QYTETAR NDERI” i Komunës së Suharekës dhe do ta regjistrojë në regjistrin e bartësve të titullit “QYTETAR NDERI” i Komunës së Suharekës.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi, kujdeset zyra e Kryetarit të Komunës së Suharekës.

### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-34858  
Më datë 31 05 2023



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. cc Bexhet KUÇI